



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64 paragrafi 2.1 Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 46 të Ligji Nr.04/L-042 Për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenin 48 të Regullores Nr.001/2022, për Prokurimin Publik, nenin 41 të Ligjit Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese, me datën 04.04.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për miratimin e rekomandimit të Sekretariatit për të zhvilluar procedurë emergjente ekstreme për aktivitetin e prokurimit “Marrja me qera e Gjeneratorit”, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan dhe Mitrovicë e Veriut

- I. Miratohet rekomandimi i Sekretariatit për të zhvilluar procedurë emergjente ekstreme për aktivitetin e prokurimit “Marrja me qera e Gjeneratorit”, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan dhe Mitrovicë e Veriut.
- II. Rekomandimi si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ, të ndërmarrë procedurat për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

KQZ, është në fazën e përgaditjes dhe organizimit të procesit të votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahën më datën 21 prill 2024. KQZ në mbledhjen e datës 03.04.2024, ka marrë vendim për zgjatjen e afatit për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës.

Duke u bazuar në problemet me energjinë elektrike, që kanë ndodhur më datën 03 dhe datën 04 prill 2024, në një pjesë qytetit të Prishtinës, përfshirë edhe lokacionin ku ndodhet objekti i KQZ dhe si rezultat i problemeve të energjisë elektrike serveret në objektin e KQZ nuk funksionojnë, si dhe platforma elektronike online për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës është jashtë funksionit.

Për shkak të nevojës së domosdoshme për furnizimin me energji elektrike, Sekretariati i ka rekomanduar KQZ-së për të zhvilluar procedurë emergjente ekstreme për aktivitetin e prokurimit “Marrja me qera e Gjeneratorit”, deri në zgjidhjen e problemit me energji elektrike.

KQZ me qëllim të implemtimit të afateve ligjore dhe operacionale për procesin e votim të datës 21 prill 2024, vendosi që të miratoj zhvillimin e procedures emergjente ekstreme për aktivitetin e prokurimit për shërbimin “Marrjes me qera e Gjneratorit”, për furnizim me energji elektrike për dhomën e serverit dhe objektin e KQZ.

Prishtinë, 04.04.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Kreshnik Radoniqi